

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE



SHËNDETI JU AJ
PRIVATËSIA JU AJ
ZGJEDHJA JU AJ


SHËNDETI JUAJ, PRIVATËSIA JUAJ, ZGJEDHJA JUAJ

UDHËZUES PËR PRIVATËSINË DHE TË DHËNAT SHËNDETËSORE

Në vitin 2008 hyri në fuqi ligji Nr.9887, datë 10.3.2008 “ Për mbrojtjen e dhënave personale”. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është i vetmi autoritet përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky ligj parashikon në nenin 7 përpunimin e të dhënave sensitive, mbrojtjen e këtyre të dhënave dhe rastet e përpunimit nga kontrolluesit. Dispozitat e këtij ligji vendosin standardet minimale që Kontrolluesit duhet t'i përmbahen gjatë mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale.

Të drejta mbi të dhënat tuaja shëndetësore do të thotë:



- ju duhet të informoheni në lidhje me të dhënat tuaja shëndetësore
- ju keni zgjedhje (akses) dhe kontroll mbi të dhënat tuaja shëndetësore
- ju mund të kërkonti që të shikoni dosjen tuaj me të dhënat shëndetësore dhe nëse ju mendoni se në të ka të dhëna jo të sakta ju mund të kërkonti korrigjimin e tyre
- ju duhet të informoheni se pse dhe kur kontrolluesi i të dhënave tuaja shëndetësore bën përpunim apo i nevojitet të shpërndajë këto të dhëna.

Cilat shërbime shëndetësore janë kontrollues sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale?

Çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale (shëndetësore).

Çdo person që ruan apo përpunon të dhënat tuaja shëndetësore ose që përgatit një recetë mjekësore. Këtu përfshihen shërbime si:

Mjekët, Infermierët, Farmacistët, Dentistët, Psikologët, Fizeoterapistët, Instruktorët në Palestra, Masazhatorët, Punonjësit social, Shërbimet për persona me aftësi të kufizuar, Shërbimet për fëmijët, etj.

Cilat janë të dhënat shëndetësore?

Çdo informacion ose opinion në lidhje me shëndetin ose paaftësinë tuaj për të kaluarën, të tashmen ose të ardhmen, gjithashtu çdo e dhënë personale e marrë gjatë një shërbimi shëndetësor si:

- simptomat që ju përshkruani apo vëzhgimet të cilat bëhen nga mjeku
- dosjet mjekësore
- recetat



- raportet patologjike, të tilla si ata që lidhen me mostrat e gjakut apo me rrezet x
- të dhënat dentare
- numri juaj shëndetësor
- informacioni gjenetik – testi gjenetik apo ai për prezumim atësie
- të dhëna të tjera shëndetësore të tilla si seksi apo gjinia



Mbledhja e të dhënave shëndetësore

Të dhënat shëndetësore duhet të mblidhen me pëlqimin tuaj me përjashtim të rasteve të parashikuar nga ligji. Ndonjëherë në lidhje me kujdesin tuaj shëndetësor, në raste emergjence ndodh që të dhënat tuaja shëndetësore të mblidhen me pëlqimin e dikujt tjetër siç mund të jetë bahkëshorti/tja, kujdestari apo ndonjë anëtar i familjes.

Zakonisht kur një punonjës i shërbimit shëndetësor ka nevojë që të mbledh të dhënat tuaja personale, ai duhet të kërkojë pëlqimin tuaj. Për të dhënë pëlqimin ju duhet të kuptoni çfarë do të ndodhë me të dhënat tuaja, prandaj punonjësit e shërbimit shëndetësor duhet të japin informacion të qartë, në mënyrë që ju të jeni në gjendje që të merrni vetë vendim për dhënien e këtyre të dhënave.

Përpunimi dhe shpërndarja

Të dhënat tuaja shëndetësore mund të shpërndahen ndërmjet subjekteve shëndetësore që kujdesen për trajtimin tuaj shëndetësor. Por kjo duhet të realizohet me mënyra dhe ndërmjet subjekteve që ju vetë pranoni. Informacioni juaj shëndetësor mund të nevojitet edhe për gjera të tjera, të tilla si menaxhimi i llogarive të veprimtarisë të subjekteve që kryejnë shërbimin shëndetësor, etj. Kontrolluesi/subjekti shëndetësor duhet t'ju informojë ju, për të gjitha qëllimet që do të përdor të dhënat tuaja shëndetësore, që ju të dini çfarë pasojash do të keni në dhënien e pëlqimit.

Aksesi dhe Korrigjimi

Ju mund të dëshironi të dini se çfarë të dhënash shëndetësore përmban dosja juaj shëndetësore dhe nëse këto të dhëna janë të sakta. Gjithashtu ju mund të kërkonit dhe një kopje të dosjes suaj shëndetësore. Nëse ju mendoni se në dosjen tuaj shëndetësore ka të dhëna jo të sakta, ju mund të kërkonit që këto të dhëna të korrigjohen apo të përditësohen.

Çfarë mund të bëni nëse mendoni se privatësia juaj është shkelur?

1. Mundohuni të zgjidhni problemin direkt me kontrolluesin/subjektin që ofron shërbimin shëndetësor duke komunikuar me të dhe duke i shpjeguar se çfarë ka ndodhur . Këtë komunikim mund ta bëni në formë zyrtare me shkresë apo me e-mail.
2. Pas 30 ditësh, nëse ju nuk keni marrë asnjë përgjigje apo nuk jeni të kënaqur me përgjigjen që keni marrë ju mund të ankoheni pranë Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale në adresën e mëposhtme :